

LETËR PUBLIKE PËR DREJTUESIT E POLITIKËS AKTUALE Z.Z. EDI RAMA, ILIR META DHE Z. LULZIM BASHA

Unë, Rrapo Hajredin Danushi, kryetar i shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve „Pronësi me Drejtësi“ në emër të pronarëve të ligjshëm, të cilëve Shteti Shqiptar, prej vitit 1991, për 23 vjet akoma nuk i ka thyer pronën e tyre të trashëguar të marrë padrejtësisht prej sistemit 45 vjeçar i diktaturës komuniste 1945-1990, deklaroj vlerësimin për **programin e qeverisë së re për pronat dhe tryezën fundit të organizuar nga Partia Republikane dt 22.12.2013.**

Fillimisht shpreh falenderim për shtypin që gjithnjë e më mirë po kryen rolin e tij si pushtet i pavarur dhe boton pa censurë shkrimet dhe opinionet për pronat.

Në një nga letrat e fundit postuar Kryeministrit Edi Rama me 22.10.2013, pas një jave **u botua ne gazetat „Sot“, „Telegraf“ dhe „Zeri i Popullit“ „Shekulli“** ne kemi renditur kërkesat tona dhe nuk kemi marrë përgjigje. Kjo dhe përgjigje të tjera të munguara si ajo e letrës së datës 19.11.2013, do të tregojnë drejtimin e kryeministrit dhe të stafit aktual. E keqja nuk ka kaluar dhe e keqja më e madhe do të kalojë kur të kthehet prona tek i zoti dhe Qeveria ta kundërshtojë realisht sistemin kleptokratik 1991-2013.

Është fakt se shumë qytetarëve agjensia e pronave i ka bërë pronarë por pa të dhëna arkivore ose me të dhëna jo të plota në vlerë dhe dihet publikisht se pronarët e vertetë janë gjykatave. Ka raste kur për të njëjtën pronë ka disa vendime gjykate dhe pronari vërtete nuk është asnjëri prej tyre por një tjetër, që nuk arrin ta fitojë gjyqin dhe arsyet dihen.

Lidhur me programin e Qeverisë Rama për pronat, ne nuk kemi qenë të ftuar dhe as të pranishëm në diskutim siç ka kërkuar OSBE dhe me 15 pikat e programit i lexuam në gazetat e datës 20.12.2013. Programi ka pasaktësi në themel dhe në bosht pasi shkel Kushtetutën dhe nuk mund të realizojë pronarë të ligjshëm me prona të ligjshme siç shkruhet në pikën e parë. Prandaj i transmetojmë publikisht Kryeministrit dhe hartuesve të programit të Qeverisë se ky program përsërit të njëjtat gabime parimore që kanë pasur programet e qeverive të majta dhe të djathta që kanë zëvendësuar njëra tjetrën prej 1991 deri në 2013 Ky program është shumë më i dëmshëm se rreziku nga armët kimike të Sirisë për të cilët u mërzit ambasadori i SHBA.

Zgjidhja e aspektit juridik të pronës mund të ishte realizuar brenda tre muajve të para të qeverisjes. Holanda, Gjermania, Britania e Madhe, Danimarka, Lituania dhe 54 institucione që e kanë të qartë krahurën e korrupsionit me pronën dhe pasojat e saj, nuk janë shtete me të cilat mund të negocjohet dhe ti premtosh siç bëhet në një fashat para fushatës e zgjedhjeve.

Sali Berisha në 1991 kryesoi pluralizmin dhe instaloi sistem kleptokratik dhe kontroll politik mbi sistemin gjyqësor. Për të treguar papërgjegjshmërinë e qeverisë Berisha që arrin deri në përpjekjen për të komanduar edhe vendimet e GJEDNJ citojmë letrën ku ai shkruan Strasburgut : “Në emër të qeverisë shqiptare i kërkojmë Gjykatës Evropiane që ankimet e përmendura të deklarohen si të papranueshme, si dhe të pranohen observacionet e palës shtetërore, duke i adresuar palët ankuese që të përdorin mjetin e brendshëm ligjor efektiv që do të zbatohet për kompensimin financiar në Shqipëri” Kjo është rruga e gabuar e z. Fatmir Mediu (kryetar i PR) për kompensimin. Protestat dhe revoltat që dëshiron të mbështeti PD, çdo javë duhet të organizohen për kthimin fizik të pronës tek i zoti dhe nuk duhet të manipulohen për rritjen e fondit të kompensimit.

Lidhur me deklarinë e paraqitur në media dt 22.12.2013 lidhur me tryezën e organizuar nga Partia Republikane sikur dy shoqatat e pronarëve bashkohen në protestë me shqatën e të përndjekurve politikë me shoqërinë civile me Partinë Republikane etj, deklaroj se pjesëmarrja e zotit Agim Toro tij është personale dhe qëndrimi i artikulluar në emër të shoqërisë civile nuk është aspak qëndrimi dhe kauza e Shoqatës “Pronësi me Drejtësi”.

Qeveria e re nuk mund të zbatojë dy standarde, të parin që dikuj i kthen pronën e trashëguar dhe dikuj tjetër nuk ja kthen pronën e tij, sepse me pushtim, korrupsion dhe të ligje që nuk përputhen me nenin 181 të Kushtetutës atë pronë e ka përfituar një shtetas tjetër që është pjesë e klaneve të politikës ose është i asaj kategorie që pëlqen përvetësimin e tokës së tjetrit që e ka marrë nga sistemi kleptokratik 1991-2013

Objekti i shoqatës tonë ka qenë dhe është kthimi fizik i pronës tek i zoti. Pronari i ligjshëm është subjekti i shpronësuar nga diktatura komuniste dhe i keqtrajtuar si kulak, vetëm sepse kishte një pasuri të

fituar me rrugët e drejta, të respektuara historikisht me përpikërinë më të lartë si në moralin dhe traditën shqiptare që nga mesjeta e njohur si Kushtetuta e Shkodrës. Pronarët dhe të përndjekurit janë plaga e shoqërisë shqiptare. Pas vitit 1945 shumë nga pronarët pasi ju konfiskuar pasuria, u diskriminuan si kulakë dhe u futën nëpër burgjet e diktaturës me sebebën e një fjale apo mendimi kritik për sistemin.

Ky objektiv i shoqatës nuk pengon asnjë individ që të kërkojë këtë kompensimin aktual që ofron Qeveria për të zëvendësuar kthimin, por Shoqata e kundërshton çdo manipulim në emër të shoqatës, çdo djallëzi dhe spekullim të politikanëve 1991-2013 që për të mbushur xhepat e tyre, kanë futur nëpër ligje frymën e shkatërrimit kombëtar. E përsërisim se mos kthimi fizik i pronës i justifikuar me këtë lloj kompensimi që nuk mbaron edhe pas 700 vjetësh, është tallje me vendimin pilot të GJEDNJ 31 korrik 2012, që ka shkakuar prishje të identitetit kombëtar ka ushqyer korrupsionin, ka mbajtur gjallë këtë hibrid të komunizmit . Ky sistem sistem kleptokratik ka mundur të realizojë që populli të manipulohet dhe të këndojë “hozana Baraba” që hajduti i madh të bërtasi “kapeni hajdutin” se na vodhi pronat, se na rrezikon demokracinë se na pengon të marrim statusin. Drejtësia nuk funksionon për sa kohë shteti nuk ekzekuton vendimet e gjykatave të formës së prerë për pronat dhe të tilla janë me mijëra, pa komentuar për vendimet e pa ekzekutuara të GJEDNJ. Kjo politikë që ka futur në luftë shqiptarët kundër shqiptarëve dhe është rruga antikombëtare me të cilën po realizohet politika e agjensive të huaja. Themel i kësaj politike është neni 8 i ligjit 7501.

Arrestimi i pushtetarëve të lartë për korrupsion që pritet me interes në shtypin e ditës, është luftë e pjesëshme me pasojat dhe jo me shkakun dhe nuk shënon plotësim të standardeve antikorrupsion që kërkohen për statusin.

Jam i detyruar të përsëris dhe të theksoj se Shoqata Pronësi me Drejtësi nuk është dhe nuk do të mund të përdoret si patericë e Partisë Republikane dhe as e partive që sot janë në pushtet. Kryetarët e këtyre forcave politike z.Edi Rama , Ilir Meta dhe z. Lulzim Basha e dinë shumë mirë se refuzimi i statusit të vendit kandidat u bë vetëm për shkak të pronës. Ishte e dëmshme për popullin fakti se problemin e pronës komisioneri Stefan Fyle e maskoi në kuadrin e termit luftë kundër korrupsionit. Problemi i pronës zgjidhet nëse zbatohet thirrja vepro tani, duke filluar nga vetë ambasadorët dhe ndonjë prej tyre përfshi ambasadorin e BE zotin Ettore Sequi dhe komisionerin Stefan Fyle, të mos vazhdojë me dy qëndrime dhe me dy karrike.

Po ashtu nëse kryeministri Edi Rama , kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta dhe kryetari i PD z. Lulzim Basha , aktualisht të veshur me pushtetin e drejtimin të politikës nuk dëshirojnë t’a shtojnë shkatërrimin që i ka bërë Shqipërisë politika antipronar e Ramiz Alisë (apo e Katovicës) e zbatuar nga 1991-2013 dhe janë të sinqertë kur deklarojnë se luftojnë për marrjen e statusit, ata le të shqyrtojnë në Kuvend sa më parë projektligjin tonë që kushdo mund ta lexojë në shqip dhe anglisht në sitin tonë www.defendingproperty.com. Ky projektligj përputhet me detyrimet kushtetuese, plotëson kërkesat e vendimit pilot të GJEDNJ, korigjon standardet e dyfishta dhe shumicën e gabimeve me pronën në periudhën e postkomunizmit. Diskutimi i këtij projektligji do të materjalizojë patriotizmin dhe përgjegjshmërinë e tyre për postin e lartë që kanë. Kthimin fizik të pronës ne nuk e kemi kërkuar si lëmshë nga kryeministrat dhe për këtë jemi shprehur me dhjetra herë në shtyp. Prona tek i zoti nuk është problem i bindjeve politike, që mund të pengohet prej numurit të kartonave dhe interesa vetiake por është detyrim kushtetues dhe njerëzor. Besoj se për këtë letër publike do ta mirëpresin dhe do të na kthejë përgjigje në gazetë z. Edi Rama, Ilir Meta , Lulzim Basha dhe do ta kenë në vëmendje pjesa e shëndoshë e shoqërisë civile si dhe ambasadorët.

Rrapo Hajredin Danushi
Kryetar i Shoqatës Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”